



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 72 Prot.

Gjirokastrë, më 22/01/2025



VENDIM

Nr. 1 Datë 20.01.2025

PËR

**NJË NDRYSHIM NË V.K.M. NR. 34, DATË 12.12.2024 NË STRUKTURËN
ORGANIKE TË QENDRËS TERAPEUTIKE PËR ZHVILLIMIN E FËMIJËVE NË
KËSHILLIN E QARKUT, PËR VITIN 2025**

Këshilli i Qarkut i mbledhur sot më datën 20.01.2025, bazuar në Ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 77/ç; Ligjin Nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Neni 30, V.K.M. Nr. 563, datë 12.8.2005 "Për përcaktimin e përgjegjësisë të qarkut për shpërndarjen e përkujdesjes shoqërore", V.K.M. Nr. 328 datë 31.05.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimi e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore".

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në strukturën organike me numrin e punonjësve të personelit të Qendrës Terapeutike për Zhvillimin e Fëmijëve në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, pagën sipas kategorisë, nivelit të arsimit, funksionit e shtesës për pozicion, për vitin 2025 (bashkëngjitur struktura).
2. Efektet financiare të zbatimit të kësaj strukture fillojnë nga 01.01.2025.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Zhvillimit Rajonal dhe Sektori i Kulturës, Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Juridik.

Ky vendim u shpall sot më datë 22/01/2025 dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

